

ikub.al shpk
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

ikub.al shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014**

Shenime	Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013	
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	3,321,323	2,778,960
Llogari të arkëtueshme	5	11,489,851	7,873,091
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	298,180	10,000
Inventari	7	1,422,868	1,422,868
Llogari kerkesa te tjera te arketueshme	8	480,804	676,710
Total Aktiveve Afatshkurtra		17,013,026	12,761,629
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	949,286	866,548
Total aktive afatgjatë		949,286	866,548
Total Aktive		17,962,312	13,628,177
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	1,833,105	1,312,280
Llogari te pagueshme tregëtare	11	8,853,314	2,811,301
Llogari te pagueshme te tjera	12	4,867,825	1,269,689
Total Detyrime afatshkurtra		15,554,244	5,393,270
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	13	4,469,280	4,471,200
Total Detyrime afatgjatë		4,469,280	4,471,200
Totali i detyrimeve		20,023,524	9,864,470
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	14	2,000,000	2,000,000
Rezerva te tjera		1,675,522	237,656
Rezerva ligjore		88,186	12,508
Fitimi i ushtrimit		(5,824,920)	1,513,543
Total kapitali aksionar		(2,061,212)	3,763,707
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		17,962,312	13,628,177

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e Te ardhurave dhe Shpenzimeve
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Shenime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura	15	21,193,514	15,915,161
Materiale te para dhe te konsumueshme	16	(14,470,689)	(5,670,930)
Shpenzime personeli	17	(8,442,632)	(6,405,679)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	18	(216,805)	(213,875)
Shpenzime te tjera	19	(3,761,004)	(1,744,030)
Fitimi operativ		(5,697,616)	1,880,647
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	20	(127,304)	(138,051)
Total shpenzime financiare		(127,304)	(138,051)
Fitimi para tatimit		(5,824,920)	1,742,596
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	21	-	(229,053)
Fitimi i vitit		(5,824,920)	1,513,543

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ikub.al shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali aksionar	Rezerva Te Tjera	Rezerva ligjore	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	2,000,000	-	-	250,165	2,250,165
Fitimi i vitit				1,513,543	1,513,543
Transferim ne rezerva te tjera		237,657	12,508	(250,165)	-
Pakesim/rritja i rezervave te tjera					-
31 Dhjetor 2013	2,000,000	237,657	12,508	1,513,543	3,763,708
Fitimi i vitit				(5,824,920)	(5,824,920)
Transferim ne rezerva te tjera		1,437,866	75,677	(1,513,543)	-
31 Dhjetor 2014	2,000,000	1,675,523	88,186	(5,824,920)	(2,061,212)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë ikub.al sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 16 Mars 2015 nga:

Albert Tollkuci
Administrator

Albert Tollkuci



Ana Qose
Hartues i Pasqyrave Financiare

Ana Qose

ikub.al shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lek)

**Paasqyra e Fluksit të Parasë
Më 31 Dhjetor 2014**

	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	(5,824,920)	1,742,595
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	216,805	213,875
Shpenzime për interesa	127,304	119,750
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	(5,480,811)	2,076,220
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi ne inventar	-	(959,753)
Ndryshimi ne llogari te arketueshme dhe te tjera	(3,709,033)	(7,787,627)
Ndryshimi ne llogari te pagueshme dhe te tjera	10,160,974	3,686,542
Ndryshimi ne parapagime e shpenzime te shtyra		(10,000)
Ndryshimi ne te ardhura te shtyra		(3,834,198)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	971,130	(6,828,816)
Interesa te paguara	(127,304)	(119,750)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjate vitit	-	(24,000)
	(127,304)	(143,750)
Aktivitetet investuese		
Blerje te aktiveve afatgjata material	(299,543)	(212,887)
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti investues	(299,543)	(212,887)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ te hyrat neto nga huate agjatgjata	(1,920)	-
Shtesa/pakesime l detyrimeve te ortakeve		4,471,200
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti financues	(1,920)	4,471,200
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	542,363	(2,714,253)
Mjetet monetare ne fillim te periudhës	2,778,960	5,493,213
Mjetet monetare ne fund te periudhës	3,321,323	2,778,960

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "ikub.al Shpk" Shpk është krijuar në vitin 2006. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

"ikub.al" Shpk është një shoqëri Shqiptare. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

- Investment SHERKO - ikub GROUP, 80% e kapitalit
- Pragmatic Software – 20% e kapitalit.

Selia e shoqërisë ndodhet në Rr. Ismail Qemali Tirane. Ajo është regjistruar në Degen e Tatimeve, Tirane me NR. NIPT K62217018V.

Administrator i shoqërisë është Z. Albert Tollkuci.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: Qender informacioni për grumbullimin, përpunimin, e shpërndarjen e sistemeve të informacionit; Qender konsulence për aktivitete të ndryshme; Konceptim, zhvillim e mirëmbajtje të sistemeve të TIK; Shpeshkime, botime, printime, fotokopjime, shumëfishime; Pjesëmarrje, ndërmjetim e investime në fushat e shërbimeve, turizmit, tregtisë, ndërtimit, prodhimit, etj; Pjesëmarrje, ndërmjetim e investime në tregun e pasurive të paluajtshme e tregjet financiare. Import-Eksport për mallra, shërbime etj

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 17 punonjës (2013: 14 punonjës).

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", Shoqëria ka vendosur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra mbi të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumëve të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që

(Vlerat janë në Lek)

Ilogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Pajisje zyre dhe informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Te tjera	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve per vitin qe mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe ate qe mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mjete monetare ne banke	519,698	1,130,433
Mjete monetare ne arke	2,801,625	1,648,527
	<u>3,321,323</u>	<u>2,778,960</u>

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kliente	11,489,851	7,873,091
	<u>11,489,851</u>	<u>7,873,091</u>

6. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Gjendjet e parapagimeve me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Parapagime per furnitoret	298,180	
AKEP parapagim per Domain	-	10,000
	<u>298,180</u>	<u>10,000</u>

7. INVENTARI

Gjendjet e Inventarit me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mallra per rishitje	1,422,868	1,422,868
	<u>1,422,868</u>	<u>1,422,868</u>

8. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Në llogaritë tjera të arkëtueshme janë paraqitur të tjera të drejta si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
ikubINFO	-	6,000
Tatimi mbi fitimin	176,688	
Taksa Vendore	-	29,069
Debitore te tjere	304,117	641,641
	<u>480,805</u>	<u>676,710</u>

(Vlerat janë në Lek)

9. AKTIVE AFATGJATA

	Mobilje dhe orendi	Kompjutera	Të tjera	Totali
Kosto				-
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	0	387,964	479,570	867,534
Shtesa	0	212,889		212,889
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	0	600,853	479,570	1,080,423
Shtesa	171,195	61,943	66,405	299,543
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	171,195	662,796	545,975	1,379,966
Zhvlerësimi i akumuluar				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012				0
Amortizimi i vitit		121,324	92,551	213,875
Gjëndja më 31 Dhjetor 2013	0	121,324	92,551	213,875
Amortizimi i vitit	86,640	123,991	6,174	216,805
Gjëndja më 31 Dhjetor 2014	86,640	245,315	98,725	430,680
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	0	387,964	479,570	867,534
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	0	479,529	387,019	866,548
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	84,555	417,481	447,250	949,286

10. HUA AFATSHKURTRA

Në këtë zë janë paraqitur huatë afatshkurtra që kompania ka kundrejt të tretëve më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
ikubINFO Software Solutions	1,298,350	1,312,280
Debitore ebuy.al	534,755	
	<u>1,833,105</u>	<u>1,312,280</u>

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime ndaj Furnitoreve për Fatura të pranuar	8,275,989	2,811,301
Detyrime ndaj Furnitoreve për Fatura të pambërritura	577,325	
	<u>8,853,314</u>	<u>2,811,301</u>

12. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga për t'u paguar	494,000	652,670
Detyrime për sigurime shoqërore & shëndetësore	158,543	151,539
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	10,598	23,826
TVSH e zbritshme	(9,520)	154,652
TVSH për rregullimin e koeficientit të kreditimit	432,604	
Tatimi mbi fitimin	-	205,053
Financim Investment Sherko	3,020,800	
Financim Pragmatic Software	760,800	
Tatim burim qira	-	40,362
Tatim burim të tjera	-	41,587
	<u>4,867,825</u>	<u>1,269,689</u>

13. HUA AFATGJATA

Në këtë zë është paraqitur hua që kompania ka marrë nga ortakët e kompanisë, Investment Sherko-ikub Group më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 :

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Hua financiare Inv Sherko	4,469,280	4,471,200
	<u>4,469,280</u>	<u>4,471,200</u>

14. KAPITALI AKSIONAR**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke.

Rezerva Ligjore

Rezerva ligjore e shoqërisë ka ndryshuar dhe është në shumen 88,186 leke.

Rezerva Te Tjera

Rezervat e tjera janë krijuar nga fitimet e viteve të kaluara për shumen 1,675,522 leke.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 5,824,920 leke përfaqëson humbjen e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Reklame në portal	18,878,646	12,771,340
Reklame në Librin e Biznesit	2,314,868	2,427,817
Zhvillim aplikacioni	-	716,004
	<u>21,193,514</u>	<u>15,915,161</u>

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

Rakordimi ndërmjet të Ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruara në FDP	<u>Dhjetor 2014</u>
Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	22,652,503
Autofatura	(1,458,989)
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	<u>21,193,514</u>
Shitje shërbime	21,193,514
Te ardhura të deklaruara në Pash që janë deklaruar shitje në FDP	<u>21,193,514</u>
Te ardhurat nga interesat	(754)
Fitim nga kembimet valutore	(71,784)
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit	<u>21,266,052</u>

16. LENDET E PARA DHE SHERBIMET

Sherbimet per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kosto e mallrave te shitura	-	313,756
Qira zyre, qira server	2,611,967	2,660,598
Reklama	6,544,334	2,674,576
AKEP	50,000	22,000
Shpenzime per plan marketingu	112,456	
Sherbime te tjera kryesore	5,151,932	
	<u>14,470,689</u>	<u>5,670,930</u>

17. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	7,236,274	5,542,318
Shpenzime per sigurime shoq e shend	1,206,358	863,361
	<u>8,442,632</u>	<u>6,405,679</u>

18. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

Shpenzimet e amortizimit per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 jane si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime amortizimi	216,805	213,875
	<u>216,805</u>	<u>213,875</u>

19. SHPENZIME TE TJERA

Shpenzimet e tjera per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 jane te analizuara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime karburanti	522,321	
Shpenzime komunikimi	506,484	785,784
Konsulence juridike, financiare	535,081	
Shpenzime sigurim/noterizim/perkthim	4,085	
Taksa vendore	25,120	54,113
Mirembajtje riparime	34,224	13,865

(Vlerat janë në Lek)

Udhetime dhe dieta	30,947	
Shpenzime kancelarie e te ngjashme	408,757	47,210
Komisione bankare	289,751	162,154
Gjoha dhe penalitete	25,359	
Te tjera	1,378,875	680,904
	3,761,004	1,744,030

20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane analizuar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te ardhura nga interesat	754	15,344
Shpenzime per interesa	(134,484)	(135,094)
Humbje nga kembimet valutote	(65,358)	(82,880)
Te ardhura nga kembimet valutore	71,784	64,579
	(127,304)	(138,051)

21. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore. Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	<u>31 Dhjetor 2014 ne Lek</u>	<u>31 Dhjetor 2013 ne Lek</u>
Fitimi Para Tatimit	(5,824,920)	1,742,596
Shpenzimet te pazbritshme	3,817,788	547,931
Shpenzime udhetimi	-	
Penalitet, gjoha e demshperblime	160	5,439
Te tjera	25,199	
Shpenzime pa fature te rregullt tatimore	3,792,429	542,492
Te ardhura tatimore	-	-
Fitimi Fiskal	(2,007,132)	2,290,527
Tatimi Mbi Fitimin (15%/10%)	-	229,053
	<u>31 Dhjetor 2014 ne Lek</u>	<u>31 Dhjetor 2013 ne Lek</u>
Tatimi Mbi Fitimin I parapaguar me 1 janar 2014	-	-
Tatim Fitimi I Parapaguar 2014/2013	176,688	24,000
Tatim Fitimi 2014/2013	-	229,053
Tatim Fitimi I parapaguar/Per tu paguar	176,688	(205,053)

22. Palet e lidhura

Gjendjet dhe transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë të detajuara si më poshtë:

Te pagueshme ndaj paleve te lidhura**Te pagueshme tregtare**

	31 Dhjetor 2014
	Ne Lek
Investment Sherko	269,069
	269,069

Hua afatshkurtra te marra

	31 Dhjetor 2014
	Ne Lek
Investment Sherko	3,020,800
Pragmatic Software	760,800
IKUBINFO Software Solution	1,298,350
	5,079,950

Hua afatgjata nga palet e lidhura

	31 Dhjetor 2014
	Ne Lek
Financim nga ortaku Investment Sherko	4,469,280
	4,469,280

Te arketueshme nga palet e lidhura**Te arketueshme tregtare**

	31 Dhjetor 2014
	Ne Lek
ikubINFO	1,761,689
Intelligent Systems Albania	78,809
	1,840,498

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

23. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

24. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.